



VENDIM

Nr. 76 Datë 08.06.2015

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË HEC
KABASH POROCAN SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC – ET “HOLTA KABASH” DHE
“HOLTA POROCAN” ME FUQI TË INSTALUAR PËRKATËSISHT 2.2
MW DHE 3.3 MW, (ME FUQI TOTALE 5.5 MW)**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.06.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC KABASH POROCAN” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC KABASH POROCAN” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HEC KABASH POROCAN” sh.p.k, për licensim në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et “Holta Kabash” me fuqi të instaluar 2.2 MW dhe “Holta Porocan” me fuqi të instaluar 3.3 MW, (me fuqi totale 5.5 MW).
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI